




KOLEGJI - COLLEGE
PJETËR BUDI
Prishtinë - Prishtina



KOLEGJI "PJETËR BUDI" - PRISHTINË

RREGULLORE PËR SIGURI NË PUNË, MBROJTJE TË SHËNDETTIT TË PUNËSUARVE DHE AMBIENTIT TË PUNËS

Prishtinë, 2020



Në bazë të nenit 17 të Statutit të Kolegjit "Pjetër Budi", Bordi Drejtues i Kolegjit "Pjetër Budi", me datë 28.12.2020 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR SIGURI NË PUNË, MBROJTJE TË SHËNDETIT TË PUNËSUARVE DHE AMBIENTIT TË PUNËS

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet siguria në punë, mbrojtja e shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës në Kolegji "Pjetër Budi" – Prishtinë, (në tekstin e mëtejshëm: Kolegji "Pjetër Budi").

Neni 2

Me siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës parandalohen lëndimet në punë, sëmundjet profesionale në vendin e punës dhe mbrohet ambienti i punës i të punësuarve të Kolegjit "Pjetër Budi".

Neni 3

- 3.1. Të drejtën për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës gëzojnë:
- 3.1.1. punëmarrësit të cilët kanë themeluar marrëdhënie të punës;
 - 3.1.2. personat të cilët janë duke kryer praktikën profesionale;
 - 3.1.3. studentët të cilët kryejnë punë praktike.

II. Obligimet dhe përgjegjësitë e punëdhënësit

Neni 4

- 4.1. Kolegji "Pjetër Budi" përmes mekanizmave të tij është i obliguar që të krijoj kushte për siguri në punë, mbrojtjen e shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës për të gjithë të punësuarit e tij.
- 4.2. Kolegji "Pjetër Budi" obligohet për ti mbuluar të gjitha shpenzimet në rastet e shërimit të lënduarve në punë dhe sëmundjeve profesionale.
- 4.3. Kolegji "Pjetër Budi" organizon dhe ndërmer masa të nevojshme për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës, duke parandaluar rreziqet në punë, përmes ofrimit të informatave dhe trajnimeve për zbatimin e këtyre masave.



Neni 5

Kolegji "Pjetër Budi" me vendim të veçantë do të bëjë vlerësimin e hollësishëm të rrezikshmërisë për secilin vend të punës, duke i marr parasysh kushtet e veçanta të punës.

Neni 6

- 6.1. Kolegji "Pjetër Budi" do të pajisë të punësuarit me pajisje personale mbrojtëse, e cila është paraparë për mbrojtje kundër ekspozimit të dëmtimeve dhe rreziqeve në punë.
- 6.2. Shpenzimet për blerjen dhe zëvendësimin e pajisjeve personale mbrojtëse, në intervale të caktuara kohore, i bart vetë Kolegjit "Pjetër Budi".

Neni 7

- 7.1. Kolegji "Pjetër Budi" është i obliguar që të ketë mjetet themelore për dhënien e ndihmës së parë dhe në rast të lëndimeve dhe të sëmundjeve të papritura, punëmarrësit ti siguroi:
 - 7.1.1. dhënien e ndihmës së parë;
 - 7.1.2. të siguroi evakuimin e të lënduarit;
 - 7.1.3. dhënien e ndihmës urgjente;
 - 7.1.4. kujdesit mjekësor;
 - 7.1.5. mbrojtjen kundër zjarrit;
 - 7.1.6. aftësimin e numrit të caktuar të punëmarrësve për dhënien e ndihmës së parë, shpëtimin dhe evakuimin e punëmarrësve në rast të rrezikut të mundshëm.

Neni 8

- 8.1. Kolegji "Pjetër Budi" në momentin e themelimit të marrëdhënies së punës, e informon punëmarrësin për rreziqet e punëve të cilat mund ti ekspozohet dhe masat për mbrojtje në punë.
- 8.2. Kolegji "Pjetër Budi" do ta informojë menjëherë organin kompetent për të gjitha rastet e fatkeqësive në punë, rastet e vdekjeve në punë dhe për të gjitha dukurit të cilat rrezikojnë jetën dhe shëndetin e të punësuarve në punë dhe lidhur me punën.
- 8.3. Kolegji "Pjetër Budi" i përgjigjet punëmarrësit për dëmin e shkaktuar me rastin e lëndimit në punë dhe sëmundjes profesionale që ka të bëjë me punën, sipas parimit të përgjegjësisë objektive të së drejtës së detyrimeve.



III. Të drejtat dhe përgjegjësitë e punëmarrësit

Neni 9

- 9.1. Punëmarrësit e Kolegjit "Pjetër Budi" kanë të drejtë dhe obligim për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit dhe ambientit të punës.
- 9.2. Punëmarrësi është i obliguar që ti përmbahet masave të nevojshme për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës si dhe të kujdeset për sigurinë dhe shëndetin e tij dhe të personave të tjerë të ndikuar nga veprimet e tij në punë.
- 9.3. Punëmarrësit kanë të drejtë të zgjedhin përfaqësuesin e tyre për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës, i cili do ta mbikëqyrë zbatimin e masave të ndërmarra nga punëdhënësi dhe do të bashkëpunojë me inspektoratin e punës.

Neni 10

- 10.1. Punëmarrësi duhet që menjëherë të njoftojë punëdhënësin e tij për çdo mangësi, rrezik, shëndetësor apo dukuri tjetër, e cila mund ta rrezikojë sigurinë e tij ose të punëtorëve të tjerë.
- 10.2. Punëmarrësi ka të drejtë të refuzojë punën, nëse ai ka arsye të besoni se ekziston rrezik i drejtpërdrejt për jetën dhe shëndetin e tij. Nëse punëdhënësi konsideron se refuzimi i punës është i pa bazuar, atëherë duhet të lajmërojë menjëherë inspektorin e punës.
- 10.3. Punëmarrësi ka të drejtë të sugjerojë përmirësimin e situatës së mbrojtjes dhe shëndetit në vendin e punës.

IV. Mbrojtja e femrave dhe personave me aftësi të kufizuara

Neni 11

Punëmarrësit - femrat shtatzëna dhe personat me aftësi të kufizuara për punë, nuk mund të sistemohen në punë veçanërisht të rënda, punë më të gjatë se orari i punës dhe në punë të natës.

V. Tualetet

Neni 12

Punëdhënësi duhet të vë në dispozicion të punësuarve dhe studentëve numër të mjaftueshëm të tualeteve dhe ti mirëmban ato në mënyrë adekuate.



VI. Ndotja e ajrit

Neni 13

- 13.1. Në ambientet e mbyllura të punës, ku punon më shumë se një i punësuar ndalohet pirja e duhanit.
- 13.2. Punëdhënësi është i obliguar që të caktoj hapësirat ku është e lejuar pirja e duhanit dhe ti siguroi ato vende me pajisje kundër zjarrit, në pajtim me planin emergjent.

Neni 14

Punëdhënësi është i obliguar që të siguroi sasi të mjaftueshme të ujit të pijshëm për të punësuarit dhe studentët.

Neni 15

Në çdo vend të punës duhet të sigurohet ndriçim i mjaftueshëm, natyral ose artificial dhe mbrojtje nga ndriçimi i tepërt.

VII. Rreziqet nga elektriciteti

Neni 16

- 16.1. Të gjitha pajisjet elektrike, duhet të kenë etiketën në të cilën shënohen karakteristikat e tyre me simbolin CE. Instalimet e rrymës duhet të bëhen në pajtim me standardet Evropiane – EN.
- 16.2. Kolegji "Pjetër Budi" ndërmerr të gjitha masat për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës nga rryma elektrike.

VIII. Zjarri

Neni 17

- 17.1. Vendi i punës duhet të jetë i pajisur me mjete përkatëse kundër zjarrit, në pajtim me planin emergjent.
- 17.2. Të punësuarit duhet të trajnohen nga punëdhënësi, në përdorimin e drejtë të mjeteve në pajtim me planin emergjent dhe në raste emergjente të veprohet sipas planit për evakuim.
- 17.3. Në raste emergjente, daljet emergjente duhet të jenë qartë të shënuara dhe duhet të kenë ndreqim emergjent.
- 17.4. Rruga kah dalja emergjente duhet të mos ketë pengesa, si dhe dyert e daljes emergjente, nuk guxojnë të jenë të mbyllura me çelës.



IX. Dokumentacioni dhe shënimet

Neni 18

- 18.1. Kolegji "Pjetër Budi" duhet të mbajë certifikatat teknike të cilat specifikojnë aplikimin e rregullave të sigurisë në punë, shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës.
- 18.2. Kolegji "Pjetër Budi" duhet të mbaj evidencën për programet e trajnimit t punëtorëve për kryerjen e punëve në mënyrë të sigurt, aksidentet në punë, rastet e lëndimeve të rënda, vdekjeve në punë, rastet e sëmundjeve profesionale

Neni 19

Me kete rregullore, shfuqizohet rregullorja e vjeter per siguri ne pune, mbrojtje të shëndetit te punësuarve dhe ambientit të punës

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Bordi Drejtues i Kolegjit "Pjetër Budi"- Prishtinë.

**Kryetari i Bordit Drejtues
Besim Ajeti**